

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6489
E martë, 14 dhjetor 2021
çmimi 0.40

A po vetërrëzohet
qeveria Kurti 2 dhe
pse po e bën këtë? | FAQE 6-7

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MUNGESA E ENERGJISË ELEKTRIKE ËSHTË BËRË TEMË DISKUTIMI
EDHE NË KUVENDIN E KOSOVËS | FAQE 4-5

POZITA DHE OPOZITA PËRPLASEN PËR KRIZËN ENERGJETIKE



Me uljen e temperaturave Kosova ka hyrë në krizë energjetike. Kryeministri Albin Kurti para deputetëve ka bërë me dije se qeveria e ka adresuar këtë çështje. Sipas tij, qeveria është duke punuar për gjetjen e një zgjidhje më të mirë për furnizim të qëndrueshëm. Ai ka thënë se konsumi i madh i energjisë po ndodh edhe për shkak të çmimit të lirë. Ndërsa ish-kryeministri Ramush Haradinaj i ka kërkuar sqarime kryeministrit Kurti se si do ta tejkalojë këtë krizë

AKTUALE




OPOZITA HEQ DORË NGA RRËZIMI I
QEVERISË SË MALIT TË ZI | F. 2

NË MUNGESË TË KUORUMIT, NUK
ZGJEDHET KRYESUESI I KUVENDIT
TË RAHOVCIT | F. 3

PDK-ja KËRKON QË QEVERIA TË
REAGJË PËR DEKLARATAT E
VULINIT | F. 3




EKONOMI



OYTETARËT E KOSOVËS
PO SHESIN DHE BLEJNË
BANESA ME KRIPTOVALUTA | F. 8

SPORT



PSG - REAL, FINALJA E
PARAKOHSHME NË LIGËN E
KAMPIONËVE | F. 10

Sali Berisha hyn në selinë e PD-së

| FAQE 5



89 PËR QIND E VIKTIMAVE NGA COVIDI NË KOSOVË, TË PAVAKSINUAR PLOTËSISHT

| FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dimitar Kovačevski, pasardhës i Zoran Zaevit në pozitën e kryeministrit

SHKUP, 13 DHJETOR - Zgjedhja e Dimitar Kovačevskit për kryetar të ri të Lidhjes Social Demokrate (LSDM) i ka hapur rrugën Zoran Zaevit që të dorëzojë në Kuvend dorëheqjen nga posti i kryeministrit të Maqedonisë së Veriut.

Zoran Zaev, dorëheqjen nga pozita e kreut të ekzekutivit, por edhe i kryetarit të partisë, e kishte paraqitur më 31 tetor, pas

disfatës së LSDM-së në zgjedhjet lokale, por në Kuvend nuk e kishte paraqitur dorëheqjen, pasi kishte thënë se do ta priste zgjedhjen e kryetarit të ri, por edhe sigurimin e shumicës në Kuvend, pas largimit nga qeveria e partisë Lëvizja Besa.

Zaevi e siguroi shumicën parlamentare pas futjes në qeveri të partisë Alternativa, që drejtohet nga Afrim Gashi. Tani

shumica parlamentare numëron 64 deputetë nga 120 sa ka Kuvendi i Maqedonisë së Veriut.

Pas arritjes së marrëveshjes me Alternativën, Zaev kishte deklaruar se priste zgjedhjen edhe e kryetarit të LSDM-së, që më pas ta deponojë dorëheqjen në Kuvend, për t'i mundësuar Dimitar Kovačevskit marrjen e mandatit për kryeministër të ri.



Opozita heq dorë nga rrëzimi i Qeverisë së Malit të Zi

PODGORICË, 13 DHJETOR - Partitë opozitare në Mal të Zi hoqën dorë nga iniciativa për ta votuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë së Zdravko Krivokapiqit. Opozita nuk ia doli të sigurojë një votë që i duhej nga partitë në pushtet për ta rrëzuar Qeverinë. Siç është njoftuar, arsyeja ishte paralajmërimi i partisë në pushtet, Fronti Demokratik (DF), që ta dorëzojë iniciativën për shkurtimin e mandatit të Parlamentit, gjë të cilën e kishte paralajmëruar të shtunën më 10 dhjetor. Nga DF-ja kanë thënë se do ta kërkojnë edhe organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Megjithatë, këtë propozim nuk e pranuan partnerët e koalicionit qeverisës. Nga 81 deputetë në Parlamentin



e Malit të Zi, iniciativën për mocionin e mosbesimit të qeverisë e nënshkruan vetëm 40 deputetë të opozitës nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS), Partia Social Demokrate dhe partitë e pakicave. Partitë në pushtet, që kanë 41

deputetë, njoftuan se nuk do t'i bashkohen kësaj nisme. Nga Fronti Demokratik, që me muaj po kërkon rrëzimin e qeverisë, thanë se nuk duan që me Partinë Demokratike të Socialistëve (DPS) të Millo Gjukanoviqit ta rrëzojnë

kryeministrin Krivokapiq. Në iniciativën e opozitës për mocion të mosbesimit ndaj qeverisë thuhej se Mali i Zi tashmë ndodhet në krizën më të madhe politike dhe institucionale në 30 vjetët e fundit dhe se qeveria e Krivokapiqit humbi legjitimitetin meqë nuk e ka përkrahjen e shumicës që e votoi.

Po ashtu, thuhej se është faj i qeverisë që bisedimet me Bashkimin Evropian në parim u suspenduan. Opozita tentoi ta materializojë pakënaqësinë me punën e qeverisë të partive në pushtet, por edhe telashet e brendshme të shumicës. Një prej këtyre problemeve është se propozimet e shumta të qeverisë së Krivokapiqit mbesin në parlament pa u vënë në

votim për shkak të mungesës së përkrahjes. Po ashtu, tash e disa muaj vazhdon edhe konflikti politik në mes të partive në pushtet, sidomos Frontit Demokratik dhe Lëvizjes qytetare Ura, pasi që disa herë, Ura voton në Parlament bashkë me opozitën e udhëhequr nga DPS-ja.

Rasti i fundit i këtillë ishte zgjedhja e Nikolla Mugoshas në postin e kryetarit të Komisionit Qendror Zgjedhor më 8 dhjetor. Qeveria e Krivokapiqit u votua më 4 dhjetor 2020 me votat e deputetëve nga Fronti Demokratik, parti kjo pro-serbe, Lëvizjes Ura dhe Demokratëve, të cilët në gusht 2020 fituan zgjedhjet me çka Partia Demokratike e Socialistëve e Gjukanoviqit pas tri dekadash kaloi në opozitë.

Kryeministri britanik nxiti qytetarët të vaksinohen me dozën e tretë

LONDËR, 13 DHJETOR - Kryeministri britanik Boris Johnson njoftoi për rritje të shtuar të vaksinimit me dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19, në mënyrë që qytetarët të mbrohen nga përhapja e varantit të ri, "Omicron". Sipas Johnsonit, vendi mund të ballafaqohet me valë të jashtëzakonshme të infektimit nga ky variant.

Nëpërmes një fjalimi televiziv, Johnson tha se secilit nga moshat 18-vjeçare do t'i ofrohet mundësia të vaksinohet me dozën e tretë deri në fund të



dhjetorit. Synimi kryesor i qeverisë britanike për vaksinim masiv me dozën e tretë ishte fundi i janarit.

Fjalimi i tij pati efekt, meqë nxiti qytetarët t'i caktojnë terminet për vaksinim me dozën e tretë, gjë e cila çoi në rënien nga sistemi të uebfaqes së Shërbimit Kombëtar Shëndetësor (NHS).

Në fjalimin e tij, Johnson tha se varianti i ri, i cili përhapet me shpejtësi të madhe, po ndikon në dyfishimin e numrit të të infektuarve. Për ta parandaluar,

"misioni kombëtar", siç tha ai, është që sa më shumë njerëz të vaksinohen me dozën e tretë.

Shkencëtarët britanikë besojnë se vaksinat ekzistuese janë më pak efektive në parandalimin e infektimit të njerëzimit e ekspozuar ndaj "Omicronit". Disa studime preliminare treguan që efekti i vaksinës shtohet mes 70-75 për qind, pas dozës së tretë. Më 12 dhjetor qeveria britanike, po ashtu, ngriti nivelin e rezikut nga përhapja e koronavirusit për shkak të variantit "Omicron".

Presidenti i Afrikës së Jugut infektohet me Covid-19

PRETORIA, 13 DHJETOR - Presidenti i Afrikës së Jugut, Cyril Ramaphosa, u diagnostikua me koronavirus. Zyra e tij njoftoi të hënën se presidenti është duke u trajtuar për simptoma të lehta. Ramaphosa filloi të mos ndihej

mirë të dielën, pasi mori pjesë në funeralin e ish-presidentit jugafrikan FW de Klerk.

Përgjegjësitë e Ramaphosas si president tani i kaluan zëvendësit të tij, David Mabuza, së paku për një javë. Ramaphosa është plotësisht i

vaksinuar, ndërkaq pas infektimit u bëri thirrje qytetarëve që të vaksinohen. "Vaksinimi mbetet mbrojtja më e mirë kundër sëmundjes së rëndë dhe hospitalizimit", tha ai. Vendi i tij është epiqendër e variantit të ri të koronavirusit, i

njohtur si "Omicron", i cili është zbuluar për herë të parë muajin e kaluar.

Që atëherë ai është përhapur në dhjetëra vende të botës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka cilësuar si shqetësues këtë variant.



89 për qind e viktimave me Covid në Kosovë, të pavaksinuar plotësisht

Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se prej 1 435 të vdekurve të shënuar nga Covid-19 në periudhën 5 gusht deri më 1 dhjetor 2021 në Kosovë, 89 për qind apo 1 280 të vdekur janë regjistruar në mesin e personave të pavaksinuar plotësisht. MSh-ja ka theksuar se vaksinat kanë rol kyç për parandalimin e infektimit, të vdekjes dhe të shtrimit në spital nga Covid-19

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije të hënën se, sipas të dhënave nga 5 gushti deri më 1 dhjetor, 89 për qind e viktimave me Covid-19 kanë qenë të pavaksinuar plotësisht. Sipas njoftimit, gjatë kësaj periudhe kanë vdekur 1 435 persona dhe 1 280 prej tyre kanë qenë të pavaksinuar plotësisht. Sipas ekspertëve shëndetësorë, që një person të konsiderohet i vaksinuar plotësisht duhet t'i marrë të dyja dozat e vaksinës dhe dy javë pas dozës së dytë ai konsiderohet i vaksinuar plotësisht. "Kjo e dhënë tregon për rëndësinë e vaksinimit të plotë në frenimin e përhapjes së Covid-19 për parandalimin e infektimit me forma të rënda të sëmundjes dhe vdekjeve nga Covid-19", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë. Duke theksuar se vaksinat kanë

rol kyç për parandalimin e infektimit, të vdekjes dhe të shtrimit në spital nga Covid-19. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, që prej regjistrimit të rasteve të para me koronavirus në marsin e vitit 2020, deri më 12 dhjetor në Kosovë kanë vdekur 2 987 persona.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 2 496 testimeve, tetë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të hënën janë shëruar edhe gjashtë qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 898. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 323.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 344 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 644 733 doza të vaksinës.

Deri më sot 772 537 qytetarë janë



vaksinuar me dozën e dytë. Bazuar në raportimet e datës 13 dhjetor 2021 nga klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, asnjë pacient me Covid-19 pozitiv nuk është duke u trajtuar në QKUK, ndërkaq në spitalet e përgjithshme ka katër pacientë të konfirmuar me Covid-19. Në QKUK po trajtohen 29

pacientë post-Covid, kurse në spitalet e përgjithshme 6 pacientë si post-Covid-19. Prej numrit të përgjithshëm të pacientëve, 9 pacientë janë me oksigjeno-terapi, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka pacientë. Të drejtë vaksinimi në Kosovë kanë qytetarët mbi 12 vjeç. Ata mund të zgjedhin vaksinën

"AstraZenca" ose "Pfizer/BioNTech", dy vaksina të miratuara për përdorim nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Agjencia Evropiane për Barna. Në Kosovë ka nisur edhe imunizimi i qytetarëve me dozën përforcuese dhe dozën e tretë dhe ato mund t'i marrin personat mbi 18 vjeç.

PDK-ja kërkon që Qeveria të reagojë për deklaratat e Vulinit

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Subjekti opozitar, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për, siç ka thënë, mosreagimin ndaj deklaratave të ministrit të Brendshëm serb, Aleksandër Vulin.

Javën e kaluar Vulin ka thënë se masakra e Reçakut ishte "gënjeshtër e madhe dhe fabrikim i jashtëzakonshëm". "Aleksandër Vulini tha që Reçaku është ngjarje fiktive. Jo që nuk pritet nga ai një gjë e tillë, por është e çuditshme që nuk pati reagim nga kjo qeveri. Reagoi ShBA-ja, reagoi Bashkimi Evropian. Çfarë reagimesh pati

nga Kosova në raport me këtë deklaratë? Është e turpshme që ne të dalim me një reagim kaq të dobët, nuk po flas si qeveri, por si Kosovë dhe shoqëri...", ka thënë deputeti i PDK-së, Adrian Kastrati, gjatë seancës plenare të hënën.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që ishte i pranishëm në seancën plenare, nuk u përgjigj ndaj kësaj deklaratë të deputetit Kastrati. Ndërkaq kreu i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se shteti i Kosovës reagon përmes proceseve gjyqësore ndaj njerëzve që mohojnë masakra të tilla. "Mos ua degradoni dinjitetin vuajtjeve dhe sakrificës së popullit të Kosovës", është shprehur Konjufca.

Në mungesë të kuorumit, nuk zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Rahovecit

Rahovec, 13 dhjetor (ER)- Të hënën është mbajtur mbledhja për konstituimin e legjislaturës së re të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për katër vjetet e ardhshëm. Në këtë mbledhje nuk është zgjidhur kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit. Fatmir

Iska nga AAK-ja ka propozuar Afrim Dinën kandidat për kryesues, kurse LV-ja, LDK-ja dhe PDK-ja kanë deklaruar se nuk kanë kandidat për kryesues. Pas përfundimit të propozimeve, anëtarët e kuvendit nga subjektet politike, LV, LDK dhe PDK, e

kanë lëshuar mbledhjen. Rasim Faliu, udhëheqës i mbledhjes, ka kërkuar nga sekretaria e kuvendit që të shikojë nëse ka kuorum për ta vazhduar mbledhjen, duke thënë se kjo mbledhje përfundon këtu deri në mbledhjen e radhës.





MUNGESA E ENERGJISË ELEKTRIKE ËSHTË BËRË TEMË DISKUTIMI EDHE NË KUVENDIN E KOSOVËS

Pozita dhe opozita përplasesen për krizën energjetike

Me uljen e temperaturave, Kosova ka hyrë në krizë energjetike. Kryeministri Albin Kurti, para deputetëve, ka bërë me dije se qeveria e ka adresuar këtë çështje. Sipas tij, është duke punuar për gjetjen e një zgjidhjeje më të mirë për furnizim të qëndrueshëm. Ai ka thënë se konsumi i madh i energjisë po ndodh edhe për shkak të çmimit të lirë. Ndërsa ish-kryeministri Ramush Haradinaj i ka kërkuar sqarime kryeministri Kurti se si do ta tejkalojë këtë krizë

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 TETOR - Kriza energjetike ka filluar ta prekë edhe Kosovën. Kjo çështje është ngritur si shqetësim të hënën nga opozita në Kuvend. Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se me uljen e temperaturave qytetarët kanë nisur të përballen me vështirësi të furnizimit të energjisë elektrike. Para deputetëve Haradinaj e ka pyetur kryeministrin Albin Kurti se si do ta zgjidhë këtë problem. "Sot dua ta shpreh

shqetësimin për gjendjen me energji. Temperaturat kanë filluar të bien dhe, po ashtu, shkurtimet e energjisë kanë filluar. Na ka ra terri. Jemi duke hyrë në një krizë energjetike. E pyes kryeministrin si do ta kalojmë këtë dimër? Çfarë strategjie do të përdorim në të ardhmen që të mos na përsëritet kjo krizë", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, qeveria është fajtoare për këtë gjendje të keqe. "Njëkohësisht Kurti i tha jo një projekti të një alternative në energji të gazit. Na la edhe pa këtë projekt. Meqë po e shohim që ky dimër është i

vështirë, si do ta zgjidhni situatën. Të lutem tregoni si do t'i mbulonit këto humbje. Mos na tregoni për veriun, sepse aty jeni treguar shumë të zotë, por për pjesën tjetër. Unë kam kërkuar debat parlamentar për këtë temë. Nuk mjaftojnë strategjitë tuaja", ka thënë Haradinaj.

I pari i qeverisë, Albin Kurti, ka pranuar se Kosova po përballlet me këtë krizë. Ai ka thënë se ekzekutivi po punon për zbutjen e kësaj gjendjeje. Sipas tij, kjo po ndodh për shkak të kërkesës së madhe të energjisë elektrike. "Në mbledhjen e fundit të qeverisë e kemi adresuar krizën energjetike që na ka trokitur në derë, por ne jemi të fundit që po na kaplon kriza. Vendet e rajonit ka kohë që e kanë këtë krizë. Është e vërtetë që po blejmë shtrenjtë energji e po shesim lirë. Rrjeti i shpërndarjes e stabilimentet prodhuese në Kosovë janë vjetruar e amortizuar, e konsumi i energjisë është rritur. Të zëmë, sot, në orën

8:00 të mëngjesit, kemi prodhuar 720 megavat, e konsumi në mëngjes ka qenë mbi 1 000 megavat", ka thënë Kurti. Sipas Kurtit, konsumi i madh i energjisë elektrike po ndodh edhe për shkak se çmimi i rrymës në Kosovë është i lirë. "Rrjeti i shpërndarjes si dhe stabilimentet prodhuese në Kosovë janë vjetërsuar dhe janë amortizuar, ndërkaq konsumi i energjisë është rritur. Ta zëmë, sot, në orën 9:00 në mëngjes, kemi qenë duke provuar me kapacitet të plotë rreth 760 megavat, ndërkaq konsumi i energjisë në orën 9:00 të mëngjesit ka qenë 1 113 megavat. Pra, konsumi është tejet i madh për shkak të stinës së dimrit dhe për shkak se mënyra jonë qoftë e punës, e banimit dhe e jetesës është e organizuar rreth ngrohjes përmes termoelektranave, që besa edhe për shkak se energjia elektrike është e lirë dhe konsumi është i kollajshëm", ka thënë Kurti.

Ndaj liderit të AAK-së ka pasur replikë edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Sipas saj, argumenti i Haradinajt, se gazi ka ndikuar në rritjen e çmimit të energjisë elektrike, është i pakuptimtë. "Pyetja si do ta kalojmë dimrin është shumë valide, por lidhja që po e bëni me gazin dhe 'Countor Globalin' s'është e saktë. Për këtë do të flasim më vonë. Kriza për energji që po përballlet bota dhe rajoni është gjendje e jashtëzakonshme dhe është shkaktuar prej çmimeve të gazit. Të ndërtohet argument për lidhjen e gazit me çmim është e pakuptimtë. Deri tash ne kemi qenë më pak të prekur se shtetet e rajonit, kemi pasur nevojë për pak import. Shtetet e rajonit veçse kanë pasur subvencione. Ne qëndrojmë mirë dhe kemi qëndruar mirë deri tash për shkak se kemi arritur kërkesën ta mbulojmë prej kapaciteteve vendore", ka thënë ajo. Ditë më parë edhe Kompania Kosovare për Distribuim të

Sali Berisha hyn në selinë e PD-së

TIRANË, 13 DHJETOR - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka shkuar të hënën në zyrat e Partisë Demokratike. Berisha ka hyrë në selinë e PD-së me mbështetësit e tij. Sali Berisha ka mbajtur një mbledhje në një sallë tjetër krahas asaj që po mbante Lulzim Basha pak metra më tej, ndërsa në përfundim foli edhe për mediet në një konferencë të gjatë. Berisha hodhi një mori akuzash

ndaj kryetarit aktual të PD-së duke e cilësuar peng të kryeministrit Rama, ndërsa tha se nuk do të hakmerrej ndaj askujt.

Berisha ka thënë se Bashën dhe Bardhin do t'i njohë si deputetë të PD-së edhe gjatë periudhës në vijim. Ai e njoftoi edhe grupin për organizimin e referendumit për shkarkimin e kryetarit të PD-së, Lulzim Basha.

Sali Berisha ka vijuar edhe sot nga

selia blu akuzat ndaj kreut të PD-së, Lulzim Basha. Sipas Berishës, Basha është i çmendur pas karriges, pasi veten e ka cilësuar si një njeri që ka pasion vetëm të punojë për liritë e demokratëve. Ish-lideri demokrat ka thënë se është miratuar një referendum për ratifikimin e Kuvendit të thirrur më 18 dhjetor. "Basha i çmendur me pasionin e karrigeve. Nga ana tjetër, njeriu i pasionit dhe misionit që është

para jush, që nuk punon për karrige, por për liritë e demokratëve dhe liritë e shqiptarëve. Në mbledhjen tonë u dërgova përshëndetje të përzemërt demokratëve në Shqipëri. Kam një thirrje të përzemërt për çdo demokrat që ende nuk ka vendosur. Është i mirëpritur dhe krah hapur. E ndoqët vetë ju kuvendin. Në rast se do të ishit në Kuvend do të mund të shprehnit lirish

opinionet. Ishte një rast i humbur por, megjithatë, unë jam një nga ata që them nga vetja ime më mirë vonë se kurrë. Unë u ktheva me vonësë. Ata nuk janë kaq të vonuar. I ftoj të bashkohen dhe kontributi i secilit do të respektohet. Në këtë familje me kushtetutë të re. Ftoj kryetarët e partive që deri më tani janë të lëkundur, të bashkohen në anëtarësitë e tyre", ka thënë Berisha.



Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve miraton dy projektligje

Prishtinë, 13 dhjetor - Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Këthim, të kryesuar nga Verica Ceraniq, kryetare e komisionit, ka shqyrtuar të hënën dy projektligje: Projektligjin nr. 08/L-066 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, me raportin dhe amendamentet e Komisionit Funkcional për Buxhet, Punë dhe Transfere si dhe shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-012 për Odat

e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, me raportin dhe amendamentet e komisionit funksional për mjedis, ushqim, bujqësi, planifikim dhe zhvillim. Në vazhdim të mbledhjes anëtarët e komisionit pa diskutim dhe me shumicë votash mbështetën procedimin e mëtutjeshëm të këtyre dy projektligjeve (për miratim) në Kuvendin e Republikës së Kosovës.



Energjisë Elektrike (KEDS) ka reaguar ndaj krizës. Kjo kompani ka kërkuar ndihmë nga të gjithë për t'u përballur me krizën energjetike. "Këto çmime marramendëse e që shkojnë mbi 300 euro për MWh po i paguajnë kompanitë KEDS dhe KESCO, pa përfshirë edhe çmimet për kapacitetet ndërkufitare e të cilat ndikojnë tutje në çmimin fundor të

energjisë së importuar", është thënë në komunikatën e KEDS-it.

KEDS-i ka treguar se mundësitë financiare janë shterur deri në fund si pasojë e përballjes me çmime të larta. "Në këtë situatë të rëndë energjetike, KEDS dhe KESCO, ashtu sikurse edhe kompanitë e sektorit të energjisë së shteteve evropiane, kërkojnë ndihmën e

të gjithë aktorëve të sektorit energjetik dhe institucioneve relevante, në mënyrë që këtë rrugë të rënduar mos ta bëjnë të vetme dhe që kjo situatë të afektojë sa më pak që është e mundur konsumatorët në këtë kohë, por edhe në të ardhmen", është thënë në komunikatën e KEDS-it.

Së fundit, tregu energjetik evropian, pjesë e të cilit është

edhe Kosova, po përballlet me çmime pesëfish më të shtrenjta në raport me vitin e kaluar.

Konsumatorët e Kosovës paguajnë 6.75 centë për kilovat në orë.

Krahasuar me vendet e rajonit, si Maqedonia e Veriut, Serbia e Shqipëria, rryma në Kosovë është më e lirë për 3 deri në 4 centë. Sipas zyrtarëve të KEDS-it, çmimi në Kosovë nuk pritet

të ndryshojë së paku deri më 1 prill 2022, kur Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ta bëjë rishikimin e rregullt të tarifave.

Për shkak të mungesës së energjisë elektrike, Zyra e Rregullatorit për Energi në Kosovë (ZRRE) dhe KEDS-i kanë kërkuar nga qytetarët që ta kursejnë rrymën në mënyrë që të mos vijë deri te mungesat.



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

A po vetërrëzohet qeveria Kurti 2 dhe pse po e bën këtë?

Jostabiliteti real përballë stabilitetit imagjinar: Qeveria Kurti 1 u rrëzua në një kohë rekorde dhe në kohën kur, për shkak të situatës jonormale shëndetësore dhe jo vetëm shëndetësore për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, nga opozita u shkëlën të gjitha parimet njerëzore dhe morale e që i pata kundërshtuar fuqishëm. U bë si u bë dhe ky rrëzim më së shumti i solli dobi pikërisht LV-së dhe Albin Kurtit që, për mrekulli, e përdorën këtë diversion dhe agresion moral të opozitës sikur edhe mungesën elementare të sensit politik për t'u mobilizuar, prandaj e krijuan distancën e pabesueshme në zgjedhjet e fundit parlamentare duke fituar mbi 50 për qind të votave e që u mirëprit nga të gjithë ata që donin dhe besonin në ndryshime. Opozita e skërmoçur, e lodhur dhe e mbaruar fare, kaloi në defensivë të plotë, pa asnjë ndikim në zhvillimet politike dhe pa asnjë mundësi ta rrezikojë pozitën. Që nga përfundimi i luftës në Kosovë kurrë nuk kemi pasur opozitë më të pafuqishme dhe, gjithashtu, as pozitë më të fuqishme. Liderët kryesorë të opozitës u dërguan si pengje në burgun e Hagës, kurse opozita aktuale "e reformuar" nuk ka asnjë ndikim, thuaja për asgjë. Kryetari i zgjedhur i LDK-së, Lumir Abdixhiku, në mënyrë elegante e forcoi pozitën e

kryetarit duke e dërguar në pension politik Isa Mustafën sikur që eliminoi nga skena politike shumë veteranë dhe themelues të LDK-së. Opozitarizmi i Lumir Abdixhikut është opozitarizëm biseksual politik; në njërin anë përpiqet të mbajë qëndrim të fortë ndaj LV-së dhe Albin Kurtit kurse, në anën tjetër, mban lidhje të fshehta me Vjosa Osmanin, si eksponentin më radikal, së paku verbal, i LV-së në përpjekje që të sigurojë strategji dalëse nëse LDK-së nuk i shkojnë punët si i ka planifikuar duke mbetur partnerë rezervë për koalicionin me LV-në. Lumir Abdixhiku nuk pati guxim politik, njerëzor e as vendosmëri të një lideri nga opozita ta dërgojë rastin e shkarkimit të Valdete Dakës në Gjykatën Kushtetuese pikërisht për shkak të biseksualitetit politik e që nënkupton të jesh i mirë me të gjithë për ta siguruar prapancën tënde. Nëse kemi parasysh të kaluarën politike të Abdixhikut atëherë mund të themi se asnjëherë nuk ka qenë "ortodoks" i LDK-së prandaj, hiç këtu edhe mungesën e karizmës, e ka shumë vështirë që në një të ardhme të afërt të bëhet papë i LDK-së. Aktualisht Lumir Abdixhiku po luan me dy palë letra, të luajturit e rolit të opozitarit dhe flirtimit prapa skene me Vjosa Osmanin dhe Albin Kurtin.

Memli Krasniqi ishte befasi kur i

hyri garës për të parin e PDK-së aq më parë që nga reperi i muzikës po përpiqet të transformohet në lider të opozitës. Të qenit nën hije për një kohë të gjatë të pamundëson rrezet e diellit politik dhe ta tëhollon lëkurën aq më parë që Memli nuk llogaritet favorit për të parin e PDK-së. Pastaj, të pranosh ta udhëheqësh një parti të fuqishme politike në kohën kur ka pësuar inflacion të votave dhe të fuqisë politike është jo vetëm sfidë, por edhe guxim. Sipas gojëdhënave popullore, të jesh i guximshëm nuk të vendosë në taborin e të mençurve! Për dallim nga Lumiri, Memli Krasniqi ka një të kaluar të gjatë në PDK, përkatësisht hapat e parë politikë i ka bërë në PDK prandaj, nëse Memli nuk është rrënja e PDK-së, atëherë lirisht mund të thuhet se nuk është dega ose gjethe e PDK-së, por është pjesë e trungut të kësaj partie. Përveç përvojës politike, Memli Krasniqi ka përvojë edhe në fushën e të drejtave të njeriut për faktin që ishte student i Shkollës Verore për të Drejtat e Njeriut në Dubrovnik ku ishte shpallur edhe studenti më i mirë i gjeneratës së tij. Të tillë ishin edhe Dastid Pallaska, Urani si dhe Shkëlzen Gashi që ishin përzgjedhur nga KMDLNj-ja. Mbetet i paharruar dhe i patejkaluar kontributi i prof. dr. Enver Hasanit, si ligjërues, gjithashtu i propozuar nga

KMDLNj-ja. Memli Krasniqi nuk ka hapësirë të madhe për të bërë reforma të mëdha dhe të thella në PDK sepse skeleti kundërshtues në PDK është shumë i fuqishëm, Memli nuk ka sharrë e as limë që: "e ha hekurin e këtij kundërshtimi" si dhe ka ende shumë pengesa në këtë drejtim, por jam i sigurt se Memli në asnjë rrethanë nuk do të pranojë: "të hyjë dhëndër me rekuizita të të tjerëve..." Nëse e mbështesin për muri me kërkesë që të bëhet konstruktiv duke e shndërruar në një marionetë, jam i sigurt se Memli do të dorëhiqet para se ta pranojë këtë rol që, për rrethanat tona në Kosovë dhe Ballkan, thuaja se është shndërruar në standard normal politik dhe moral, të noterizuar nga vlerat që çdo gjë mund të jenë vetëm moral jo! AAK-ja dhe Ramush Haradinaj është dhe janë atraktive vetëm nëse duhet ta zbatojnë në praktikë parimin: "destabilizo, për të stabilizuar" për faktin se nuk kanë shumë numra, por se kanë kapacitet dhe përvojë të imponohen si faktorë ndërmjetësues dhe përcaktues për vendosjen e një baraspeshe institucionale, në rast se kërkohet një tranzicion i pushtetit dhe qeverisjes, së pari, dhe kryesisht nga ndërkombëtarët. Nëse e kemi parasysh formulën e fuqisë politike në Kuvendin e Kosovës sikur edhe mosgatishmërinë e

unifikimit opozitar, atëherë lirisht mund të themi se, nëse i referohemi opozitës aktuale, Albin Kurti mund të qeverisë Kosovën edhe në 500 vjetët e ardhshëm, disi si padishahët e Stambollit. Rezultatet e zgjedhjeve të fundit lokale nuk është se e dëmtojnë fort Albin Kurtin e as që e rrezikojnë qeverisjen aktuale. Duket se opozita as që është e interesuar të marrë përgjegjësi për udhëheqje të Kosovës duke ia lënë "këmbët e arushës" koalicionit qeverisës në përpjekje ta adresojë përgjegjësinë pikërisht te ky koalicion edhe për të bëmat që kanë pjellë nga ngjizja e tyre sikur që janë: Zajednica, rryma pa pagesë për serbët në veri të Kosovës, Manastiri i Deçanit dhe të tjera. Po pse LV-ja dhe Albin Kurti kanë hyrë në rrugën e vetërrëzimit vullnetar apo do të përjashtohen nga qeverisja nga ndërkombëtarët, përmes pykave të prodhimit vendor si puna e Vjosa Osmanit dhe haxhiqamillëve të saj!

Bisedimet me Serbinë: Kosovës i ishin imponuar bisedimet me Serbinë të kontrabanduara si teknike, kurse përmbajtja ishte krejtësisht e natyrës politike. Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë si puna e bareshës Ashton, të papërcaktuarit Kuper, italianes Mogerini që serenatat e bukura italiane i kishte shndërruar në Zhikino Kollo (Valle të Zhikes)

serbe e sidomos të Miroslav Lajçakut, mashtruesit dhe gënjeshtarit mohues të statusit politik të Kosovës, nën urdhër të një pasuesi të Francisko Frankos të Spanjës e që është Borrelli që, në variantin më të butë, ka sjellje fashiste ndaj Kosovës, sollën në një udhë qorre, ku jo që nuk kishte as shkëndijë e lëre më dritë në fund të kësaj rruge por, përkundrazi, e ngatërruan çështjen aq shumë, deri në situatë kur lehtësisht do të shkaktonte një luftë të re në Kosovë. Serbia fashiste e Millosheviqit dhe neofashistit Aleksandër Vuçiq jo që nuk u ndëshkua për krimet e luftës në të kaluarën dhe krimet e projektuara për të ardhmen, por u shndërrua në partner bashkëpunimi ushtarak, ekonomik, politik dhe strategjik në Ballkan duke ia dorëzuar çelësat e ruajtjes së rendit pikërisht shkaktarit kryesor për këtë gjendje në Kosovë – Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe pjesërisht në Maqedoni të Veriut, shovinistit, fashistit dhe kryeçetnikut të Ballkanit, Aleksandër Vuçiq që, në të njëjtën kohë, është padre padrino (koka) e mafies dhe krimin të organizuar në Ballkan. Serbia është në përparësi absolute për faktin që lojën politike e ka zhvendosur 100 përqind në territorin e Kosovës dhe të gjitha kombinimet apo “kompromiset e dhimbshme” kanë të bëjnë vetëm me Kosovën dhe shqiptarët e Kosovës, të cilëve ende plagët u pikojnë gjak dhe ende nuk i kanë varret për t'i qarë të dashurit e tyre! Në këto rrethana, poshtëruese dhe shantazhuese, asnjë udhëheqës i Kosovës nuk do të duhej ta pranonte ilačin e shkruar sipas recetës së Serbisë e as Albin Kurti, më së paku, madje sepse duke i kundërshtuar të gjitha këto, e them me të drejtë, i fitoi 50 përqind të votave! Tash Albin Kurti po përballet me një presion (relativisht të butë) për t'i vazhduar bisedimet me Serbinë ku do të bisedohej për Zajebnicën (shprehje nga LV-ja e përdorur si mjet lufte për të ardhur në pushtet), pronat e Kishës Ortodokse, demarkacionin e kufirit me Serbinë, pronat e serbëve dhe të tjera që vetëm sa e rëndojnë procesin duke i krijuar përparësi Serbisë dhe duke e thelluar pozitën defansive të Kosovës. Delegacioni i Kosovës po merret me përpjekje të mbushjes, jo të vrimave, por të zgavrave që janë krijuar në bisedimet paraprake për çka, padrejtësisht, sulmohen ish-drejtesit e Kosovës. Jam i sigurt se çdonjëri që do të ishte pjesë e proceseve të mëparshme do të detyrohej të pranojë atë që kanë nënshkruar. Lëshimet janë bërë në Rambuje, në Marrëveshjen e Kumanovës nuk kemi qenë as 10 km në perimetrin e vendit ku ishte

arritur marrëveshja midis KFOR-it dhe gjeneralëve dhe vojvodëve të Serbisë. Në bisedimet e Vjenës negociatorët kanë mbushur xhirollogaritë, kurse dëmin më të madh Kosovës, në aspektin politik, juridik dhe strategjik i ka shkaktuar kriminelin juridik, Mati Ahtisari, me Pakon e tij famëkeqe që e dhunon përmbajtësisht dhe formalisht Kushtetutën e Kosovës. Fusnota apo Ylli i Zezditës që nuk u shkri, “si një fjollë bore”, është e keqja më e vogël që i ka ndodhur Kosovës. Në aspektin afatgjatë, Kosovën e dëmton, e them pariparueshëm, Gjykata Raciste Speciale që po mban peng qytetarë të Kosovës, sakrifikuës dhe krijues të këtij gjysmështeti që e kemi, edhe në rast se të gjithë do të lirohen si të pafajshëm. Themelimi i kësaj Gjykate Raciste Speciale, në bashkëpunim me Serbinë dhe të një pjese të establishmentit politik të Kosovës, skajshmërisht relativizon krimet, deri në genocid që i bëri Serbia në Kosovë sikur përpjete që për të gjitha krimet në Kosovë gjatë dhe sidomos pas Marrëveshjes së Kumanovës përgjegjësia të adresohet te pengjet shqiptare që po mbahen peng në Gjykatën Raciste Speciale të Hagës.

Krahasimi i pavend midis Kosovës dhe Bosnjë dhe Hercegovinës: Politikanët kosovarë, me injorancën e tyre antologjike dhe në pamundësi të kundërshtimit arsyetohen: “Nuk do të lejojmë të ndodhë bosnjëzimi i Kosovës ...” në kohën kur në Kosovë e kemi gjendjen më të keqe. Pse? Në Bosnjë dhe Hercegovinë i kemi tri entitete politike dhe etnike homogjene dhe me kufij të përcaktuar dhe, në çastin kur vlerësojnë se nuk ia vlen të bashkëjetojnë, ndarja e tyre më shumë ose krejtësisht është e natyrës teknike. Manovrat që po i bën tash Dodiku, nuk janë përpjekje për ndarje, por përpjekje për t'i shpëtuar lëkurën, dhe jo vetëm lëkurën politike të padronit Aleksandër Vuçiq. Edhe komunitetit ndërkombëtar vendimmarrës i ka konvencuar kjo Bosnje si është dhe ky Dodog si është për të vendosur rend dhe kufij të tjerë në Ballkan, në të kundërtën do ta fshinin Dodigun, me një puhizë pordhash të ftohta. Në Kosovë nuk e kemi dhe as mund të krijohet arkitektura e bosnjëzimit të Kosovës, por e kemi rastin tipik të leopardizimit të territorit të vendit e që është shumë më vështirë të bëhet një zgjidhje, qoftë edhe me lëshime territoriale. Kjo është merita kryesore e kriminelit juridik Marti Ahtisari. Të ishte Zajebnica vetëm me komunat e Kosovës së pushtuar veriore, do ta bënim një zgjidhje më të lehtë, kurse Zajebnica e leopardizuar e bën Kosovën

shumë të cenueshme duke e mbajtur në destabilizim të përhershëm. Ky është shërr më i madh për Kosovën dhe shkaku se serbët e Kosovës sikur edhe Serbia asnjëherë nuk do të pajtohen me asgjë që u jepet, tash kanë më shumë të drejta dhe privilegje se vetë shqiptarët që janë shumicë absolute. Kosovës i duhet një zgjidhje radikale, ndryshe do të shndërrohet në një vend me konflikt të ngrirë që i përshtatet Serbisë dhe në asnjë mënyrë Kosovës. Konflikti i ngrirë u përshtatet politikanëve kosovarë për ta marrë apo qëndruar në pushtet dhe në asnjë mënyrë zhvillimit të Kosovës. Për këtë arsye angazhimi i Shqipërisë është i pashmangshëm për faktin se jo më larg se 10-15-vjeçarit e ardhshëm, Kosova do të bëhet pjesë e Shqipërisë. Ndoshta edhe më shpejt! Listat e zeza të SHBA-së aspak nuk e dëmtojnë Serbinë, madje vetëm sa e forcojnë lidhjen e Serbisë me Rusinë, Kinën, Indinë, Turqinë, kurse te shqiptarët, në Kosovë dhe Shqipëri, e nxisin një luftë brendashqiptare, me ç'rast energjia shpenzohet në luftë midis një populli sikur që ishte dhe është gjendja në Shqipëri ku, nga një Parti Demokratike e Shqipërisë, u bënë dy Parti Demokratike e që aspak nuk e ndihmon, as Shqipërinë, as demokratizimin e as luftën kundër korrupsionit. Në këtë drejtim nuk ka fare dallim midis Berishës dhe Bashës, midis Ramës dhe Metës (i pushkatuari i radhës nga listat e zeza)! ShBA-ja, e sidomos BE-ja, shumë kanë investuar në Vuçiqin për ta larguar aq shpejt aq më parë që opozita e sotme në Serbi është më radikale se vetë Vuçiqi sa i përket Kosovës. Albin Kurti nuk do të ketë presion të madh për bisedime shkaku se janë festat e fundvitit, do të ketë zgjedhje në Serbi, Mal të Zi (apo formohet një qeveri tjetër) dhe Maqedoni të Veriut. Në Kosovë nuk ka asnjë arsye e as vullnet nga opozita të ketë zgjedhje të reja. Ndërkombëtarët do të vendosin për këtë.

Pasi të sigurohen adresat për mandat të ardhshëm të qeverisjes në këto shtete, vetëm atëherë Albin Kurti do t'i nënshtrohet një presioni për vazhdim të bisedimeve dhe do t'i ofrohet, sikur gjithë shqiptarëve, mundësia e vetme, lëre ose merr çka të ofrohet! Për këtë arsye mendoj se, përkundër shumë gabimeve të qeverisë Kurti 2, opozita, shoqëria civile dhe të tjerët duhet ta përkrahin Qeverinë Kurti 2 100 përqind, derisa të arrihet një marrëveshje me Serbinë. Është çështje tjetër nëse qeveria Kurti 2 vetërrëzohet! Ky do të ishte fundi politik i Albin Kurtit sepse nuk do të kishte mundësi të tretë të qeverisë së Kosovës! Kosova nuk është më as prioriteti i 500 i

komunitetit ndërkombëtar përveç ëndrrave që i shohim me sy hapur!

Ku “rrëshqiti” Albin Kurti: Në zgjedhjet e fundit parlamentare Albin Kurti dhe LV-ja morën aq shumë pushtet e që nuk kishin mundësi ta mbushnin me resurse të kualifikuara, profesionalisht, politikisht e, më së paku, kombëtarisht! Kjo i bie sikur aeroplanin luftarak, në vend që ta mbushni me kerozinë të pastër, e mbushni me naftë të Rafinerisë së Ballshit, ku raporti është 60 për qind ujë dhe 40 për qind naftë të varfëruar. Përfunduar disa ministra, shumë prej tyre janë katastrofë elementare, ambientale, politike, profesionale e për kombëtare as që e vë si kriter. Nga bërthama e dikurshme e LV-së, ka mbetur një numër i papërfillshëm që trajtohen si raste sociale, ndërsa kanë ardhur mbetjet dhe stërmbetjet e atyre që në kohën më të vështirë për Albin Kurtin dhe LV-në, pa asnjë kriter dhe pa asnjë moral e kanë pushkatuar Albinin dhe LV-në, si lëvizje etnocentrike dhe nacionaliste! Këta i ka shpërblyer Albini duke i bërë ambasadorë, negociatorë, ministra, kryetarë bordesh dhe pozita të tjera udhëheqëse. Kur Albin Kurti doli nga burgu i Pozharevcit, të gjitha rrugët ia hapi Adem Demaçi, Behxhet Shala, Shashivar Makolli, Muhamet Mavraj dhe shumë të tjerë. Sepse kemi besuar se Kosovës i duhet ndryshimi. Muhamet Mavraj, me gazetën “Epoka e re”, i ka dhënë hapësirë Albin Kurtit në kohën kur asnjë medium nuk ka pasur guxim ta bëjë këtë, madje vetëm e kanë luftuar. Për këtë arsye Muhamet Mavraj e solli gazetën buzë falimentimit. Ky është sot respekti i Albin Kurtit për Muhamet Mavrajn?! Muhamet Mavraj më ka dhënë hapësirë në çdo kohë të shkruaj për gazetën “Epoka e re” për Albin Kurtin dhe LV-në në kohën kur mediet e tjera publikisht më denonconin për t'u hyrë nën bisht ambasadorëve të fuqishëm, si mbrojtës i Albin Kurtit dhe i LV-së. Shkrimet e mia në “Epokën e re” në atë kohë, në aspektin material, e kanë dëmtuar shumë këtë gazetë dhe kush e vlerëson sot për këtë?! Këta injorantët e LV-së që janë LV për aq sa unë jam anëtar i partisë së Hamit Karzait apo Zhan Mari të Penit sot po paraqiten më LV se vetë Albin Kurti dhe të tjerët e, në fakt, janë mercenarë të stërpërdorur që nga koha e ish-Jugosllavisë, Serbisë, UNMIK-ut dhe EULESH-it. Nga viti 2004, KMDLNj-në e kanë dëmtuar pikërisht ngjarjet e marsit sikur edhe Albin Kurti dhe LV-ja. Kjo histori po përsëritet edhe sot, disa eksponentë të LV-së duan ta dëmtojnë KMDLNj-në. Për këtë një herë tjetër, me emra dhe mbiemra! Nuk ma ha mendja se

Albin Kurti qëndron prapa kësaj. Po flas për përkrahësit e hershëm e kohët më të vështira për LV-në dhe Albin Kurtin. Së voni, një zonjë e vërtetë e shkronjave në gjuhën shqipe që para zgjedhjeve të fundit parlamentare, nuk la shkrim pa përdorur në përkrahje të Albin Kurtit dhe LV-së, përjashtuar këtu bombën atomike që nuk e kishte në dispozicion, Kimete Berisha, tash, kur ka një qëndrim ndryshe, falangat e islamit verbal të rrjeteve sociale të një pjese të LV-së po e persekutojnë duke mos lënë mjet pa keqpërdorur kundër një zonje që, para së gjithash, është reale, mendon (shihe ti, paska shqiptarë që mendojnë) me kokën e saj, dhe nuk pranon asnjë post për ta korruptuar intelektualizmin e saj për ta shprehur mendimin e saj, dikur lavdërues për Albin Kurtin dhe LV-në e tash kritik - zhgënjyes për Albin Kurtin dhe LV-në. Albin Kurti do të duhej ta ftonte Kimete Berishën si këshilltaren kryesore dhe të lirohet nga këshilltarët që ia mbajnë çantën, fjalimin dhe rrahin shuplakë, ende pa e filluar fjalimin. Albin Kurti, nuk po e them LV-ja se vetë Albini është LV, pa Albinin nuk ka LV, nuk ka Listë Guxo, nuk ka Presidencë e as presidente, duhet të vendosë kontroll të rejtë vetëm për përmbyshjen e parimeve dhe premtimeve dhe në asnjë mënyrë të vendosë kontroll në qëndrimet e opozitës dhe kundërshtarëve politikë që e kundërshtojnë, por që e duan Kosovën dhe qytetarët e saj duke kontribuar për një jetë më të mirë, në të gjitha aspektet. Në këtë kontekst mendoj se Albin Kurti duhet të përkrahë, duhet të ndihmohet dhe nuk duhet as që të mendohet që të rrëzohet qeveria Kurti 2. Askush nuk duhet t'i gëzohet dështimit të Albin Kurtit e as qeverisë Kurti 2 për faktin se çdo dështim do të jetë dështim i Kosovës dhe se me çdo dështim pazari i Kosovës do të ulet më shumë e që nuk është interes i askujt përveç Vuçiqit dhe Serbisë. Thirrja në miqësi të përhershme me Amerikën (kjo miqësi nuk është e garantuar as me gruan apo burrin në një lidhje martesore) e lëre më në politikë ku mbizotëron 100 përqind interesi politik - dashuria politike, është përpjekje e pandershme për të fituar politikisht. Është impotencë e veprimt politik, mungesë e shtyllës kurrizore dhe përpjekje e pamoralshme për ta luftuar apo diskredituar kundërshtarin politik, në rastin konkret Albin Kurtin, kryeministër i Kosovës. Mos e shani, mos e sulmoni për aq kohë sa ka nevojë për përkrahjen dhe ndihmën tuaj, nëse ka nevojë. Nëse nuk ka nevojë përsëri ia kushtoni himnin e Liverpulit: “you never walk alone” sepse askush i vetmuar nuk ka arritur një qëllim që është interes i të gjithëve!

Qytetarët e Kosovës po shesin dhe blejnë banesa me kriptovaluta

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Nga pagesa e kafesë deri te blerja e banesave, qytetarët në Kosovë, në disa kompani, mund të përdorin kriptovaluta apo, siç njihen ndryshe, para digjitale. Sipas zyrtarëve të Bankës Qendrore të Kosovës, vlera e transaksioneve të bëra për blerjen e kriptovalutave në Kosovë, në gjashtë vjetët e fundit, ka arritur në rreth 10 milionë euro, ndërsa shitja e tyre kap shumën e 1.76 milion eurove.

Nga kureshtja për t'u njohur me paranë digjitale, lokali i pijeve "N'dritare", në qytetin e Ferizajt, ka filluar pagesën e produkteve, konkretisht të kafesë dhe pijeve të tjera, me kriptovaluta, qysh në vitin 2018.


Alban Bytyqi, bashkëpronar i këtij lokali, thotë se interesimi i qytetarëve për këtë lloj pagese ka qenë më i madh para tre vjetësh sesa tani. "Më shumë ka qenë si atraksion për qytetarët që e kanë shfrytëzuar si formë pagese [kriptovalutën]... Tash ka rënë në zero [pagesa] me Bitcoin, pasi qytetarët kanë nisur ta kuptojnë se Bitcoin është më i mirë si formë e kursimit sesa si formë e pagesës", thotë Bytyqi për "Radion Evropa e Lirë".

Në botë ekzistojnë mbi 5 000 kriptovaluta të ndryshme, por më të popullarizuarat mbeten Bitcoin dhe Ethereum.

Personit i duhet një "portofol", apo një aplikacion online, përmes të cilit transferon para reale për blerjen e kriptovalutave.

Kriptovalutat mund të përdoren për të blerë mallra dhe shërbime të zakonshme, ndonëse shumë njerëz investojnë në to sikurse në pasuri të tjera, të tilla si aksionet apo metalet e çmueshme. Sipas të dhënave zyrtare në Kosovë, rreth 10 mijë operatorë të identifikuar - persona fizikë dhe juridikë - llogaritet se kanë investuar apo përdorin kriptovaluta.

Kompania ndërtimore "Pozhegu Brothers", me seli në



Prishtinë, ka kohë që ka filluar ofertën e shitjes së banesave me Bitcoin.

Pronari i kompanisë, Qemajl Pozhegu, thotë se ka interesim të madh për të paguar me para digjitale, sidomos nga të rinjtë, porse ende nuk është realizuar ndonjë shitblerje. "Ne nuk pranojmë Bitcoin, por bashkëpunojmë me Zyrën e Këmbimit Valutor që operon në Prishtinë. Nëse klienti vjen të blejë banesë me kriptovalutë, ne e lidhim me këmbimore. Ata i transferojnë mjetet nga kriptovaluta në euro dhe klienti paguan produktin me euro", thotë Pozhegu.

"Radio Evropa e Lirë" ka vizituar disa zyra të këmbimit valutor për t'u interesuar për mënyrën e blerjes dhe shitjes së kriptovalutave.

Në këto zyra qytetarët mund të blejnë, shesin apo hapin llogari

të kriptovalutave. Sipas punonjësve, tregtimi me kriptovaluta nuk është proces i vështirë, por ata nuk japin shumë detaje. Ata thonë se interesimi i qytetarëve është i madh, sidomos për blerjen e tyre.

Pronarët e këmbimoreve në Prishtinë nuk kanë pranuar të prononcohen dhe identifikohen për "Radion Evropa e Lirë".

Në Bankën Qendrore të Kosovës këto zyra janë të licencuara për këmbimin e valutës vendase me valuta të huaja dhe anasjelltas, por jo për këmbim të parasë digjitale. Më 3 dhjetor Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka lëshuar një komunikatë për media, duke u bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës që gjenerojnë të ardhura nga kriptovalutat, t'i deklarojnë ato

dhe të paguajnë tatim për to.

Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se për administratën nuk është me rëndësi se cilën valutë e përdor biznesi apo qytetari. E rëndësishme, sipas tij, është të kryhen obligimet tatimore. "Kemi informata për zhvillim të këtyre aktiviteteve. Numra nuk mund të themi, sepse ndryshojnë nga dita në ditë dhe nga çasti në çast, mirëpo këto transaksione do të trajtohen nga ATK-ja, sepse e kemi detyrim ligjor që të trajtojmë çdo aktivitet ekonomik që zhvillohet brenda territorit të Kosovës", thotë Murtezaj.

Albani Bytyqi, bashkëpronar i lokalit "N'dritare", tregon për "Radion Evropa e Lirë" se si i ka paguar tatimet për qarkullimin që ka pasur në kriptovaluta: "Kemi pasur vizitë nga ATK-ja dhe ia kemi sqaruar se kur

klienti bën porosi, kuponin fiskal ne e pritojmë në euro, nuk kemi të drejtë të lëshojmë kupon fiskal në Bitcoin. Mirëpo, pagesën e marrim në llogarinë tonë personale të Bitcoinit. Nuk kemi llogari të biznesit në Bitcoin, sepse nuk ka ligj që e rregullon këtë çështje në Kosovë. Por, ato mjete i kemi bartur në llogari personale".

Republika e Kosovës deri më tash nuk ka ndonjë ligj që rregullon tregun e kriptovalutave. Kuvendi është në përgatitje të një projektligji të tillë, i cili do t'i përcaktojë rregullat e përdorimit të parave digjitale brenda territorit të Kosovës.

Përveç kategorizimit të kriptovalutave dhe të formave të tatimit, ligji synon të krijojë edhe një evidencë të saktë të personave që operojnë me kriptovaluta në Kosovë.


Ministria e Infrastrukturës: Rruga Prizren - Prevallë është e pakalueshme



PRISHTINË, 13 DHJETOR (ER) - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka njoftuar se rruga rajonale Prizren - Prevallë është e pakalueshme për shkak të rrëshqitjes së dheut. Sipas MI-së, të gjitha rrugët e tjera në Kosovë janë të qarkullueshme për automjete. "Të gjitha rrugët janë të qarkullueshme për automjete përveç rrugës rajonale R113, Prizren - Prevallë.

Në këtë pjesë mbrëmë pas orës 18:00 ka pasur rrëshqitje të dheut nga ana e sipërme e rrugës, në mes të dy tuneleve, ana e djathtë e drejtimit Prizren - Prevallë dhe për pasojë është bërë bllokimi i rrugës. Ky bllokim vazhdon edhe sot për arsye të rrezikut nga ndonjë rrëshqitje tjetër në vendin e ngjarjes. Brenda ditës do të shohim për mundësinë e funksionimit të ndonjë

alternative tjetër për qarkullimin e trafikut Prizren - Prevallë", ka njoftuar Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Pas reshjeve të borës dhe shiut, sipas MI-së, kompanitë e kontraktuara kanë intervenuar në pastrimin e autoudhëve dhe rrugëve kombëtare dhe rajonale dhe me shpërndarje të kripës për qarkullimin sa më të sigurt të automjeteve.



PSG - Real, finalja e parakohshme në Ligën e Kampionëve



Nyon, 13 dhjetor - Shorti i fazës së 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve është përsëritur, pasi një gabim teknik në sistem e detyroi UEFA-n ta shpallë të pavlefshëm atë short dhe të vendosë që ai të hidhet përsëri në orën 15:00.

Ndeshja kryesore e këtij rrethi do të jetë në mes të PSG-së dhe Real Madridit. Edhe dy ndeshje të tjera do të jenë shumë interesante si ajo në mes të Interit dhe Liverpoolit dhe Atletico Madridit dhe Manchester Unitedit. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 15, 16, 22 & 23 shkurt të vitit 2022, ndërsa ato të kthimit më 8, 9, 15 & 16 mars. Finalja e Ligës së Kampionëve do të zhvillohet më 28 maj në "Kerstovsky Stadium" në Saint Petersburg të Rusisë. Nga

1/8 e finales do të futet në fuqi edhe rregulla e re, aty ku nuk do të vlejë më rregulli i golit si mysafir. I ashtuquajtur i rregulli i golave si mysafir është hequr, kështu që ndeshjet që mesin me barazim pas 180 minutave do të shkojnë në kohën shtesë, pavarësisht nga numri i golave që çdo ekip ka shënuar në shtëpi dhe jashtë. Nëse skuadrat ende nuk mund të shënojnë gola pas 30 minutave shtesë, ndeshja shkon në penallti.

Barcelona përballet me Napolin

Barcelona do të përballet me Napolin në 1/8 e finales së Evropa Ligës, garës dytësore evropiane për klube, pas shortit që u hodh të hënën në Nyon. Barcelona

dështoi të kualifikohej në rrethin e 16 më të mirëve në Ligën e Kampionëve për herë të parë prej vitit 2003, duke përfunduar në vendin e tretë në grup. Prandaj gjiganti katalonas kaloi direkt në 1/8 e finales në Evropa Ligë, ku do të përballet me Napolin. Duel tjetër interesant i kësaj faze është ai në mes të Portos dhe Lazios. Borussia Dortmundi do të përballet me Rangersin, ndërkohë që Sevilla me Dinamon e Zagrebit.

Tërhiqet shorti në Ligën e Konferencës

Është tërhequr shorti edhe për eliminimin direkt në Ligën e Konferencës. Skuadrat që u kualifikuan si pozitë e dytë do të

përballet me ato që vijnë nga pozita e tretë e Ligës së Evropës. Tërheqjen e këtij shorti e bëri kapiteni legjendar i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana.

Ndeshjet e para zhvillohen më 17 dhe 24 shkurt. Kujtojmë se stadiumi "Air Albania" është nikoqir i finales që do të zhvillohet më 25 maj të vitit të ardhshëm.

SHORTI I LIGËS SË KAMPIONËVE

Salzburg - Bayern Munich
Sporting - Manchester City
Benfica - Ajax
Chelsea - Lille
Atletico Madrid - Manchester United
Villarreal - Juventus
Inter - Liverpool
PSG - Real Madrid

Barcelona - Napoli
Zenit - Real Betis
Dortmund - Rangers
Sheriff Tirasport - Braga
Porto - Lazio

SHORTI NË LIGËN E KONFERENCËS

Marseille - Qarabag
PSV - Maccabi Tel Aviv
Fenerbahçe - Slavia Praha
Midtjylland - PAOK
Leicester City - Randers FC
Celtic FC - FK Bodo/Glimt
Sparta Praha - FK Partizan
SK Rapid Wien - Tottenham/Vitesse

SHORTI NË LIGËN E EVROPËS

Sevilla - Dinamo
Atalanta - Olympiacos
RB Leipzig - Real Sociedad

Arti Hajdari, MVP në Ligën Unike

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Xhiroja e gjashtë në Ligën Unike ka dhuruar ndeshje interesante. Në katër duelet fitore shënuan skuadrat nga Kosova, kurse rezultati më i ngushtë ishte i ndeshjes në Prizren, ku Prizreni 16 fitoi ndaj Teutës me rezultat 109:97, në një duel ku u vendos në çerekun e fundit. Në këtë sfidë u dallua Arti Hajdari me 35 pikë, katër

kërcime dhe katër asistime. Hajdari shënoi 12 pikë në periudhën e fundit, duke qenë vendimtar për skuadrën e tij. Paraqitje të mirë kanë bërë edhe dy basketbollistët e Golden Eagle Yllit, Henrik Sirko dhe Gëzim Morina në duel ndaj Tirana Neptun. Sirko kontribuoi me 23 pikë, katër kërcime dhe gjashtë asistime, ndërsa Morina me 14 pikë, shtatë kërcime dhe

tetë asistime. Peja mundi Vllazninë e Shkodrës në udhëtim 76:101, ku më i dalluari për pejanët ishte Stephen Maxwell me 23 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime. Rahoveci shënoi fitoren e dytë radhazi, duke mundur Kamza Basket me shifrat 98:56, ndërsa më i dalluari te Vreshtarët ishte Tyheim Monroe me 17 pikë, 12 kërcime dhe dy asistime.



Aguero të mërkurën njofton pensionimin nga futbolli

Barcelonë, 13 dhjetor - Një muaj pasi doli nga fusha për probleme kardiake, dhe pas njoftimit të klubit se Sergio Agüero do të qëndrojë jashtë fushave për rreth tre muaj,

nga Spanja vijën lajme aspak pozitive. Sipas asaj që shkruajnë mediet iberike, sulmuesi argjentinas ka vendosur të mos rikthehet më në fushat e lojës duke i dhënë

lamtumirë futbollit të luajtur. Agüero pritet të dalë në një konferencë për shtyp të mërkurën për të bërë publik këtë vendim të hidhur. Sulmuesi argjentinas u

transferua te Barcelona gjatë merkatos së verës me shpresën që të luante përkrah Leo Messit, por “pleshti” zgjodhi të transferohet në Paris, ndërsa Agüero



Ademi: VAR-i e bëri garën shumë më korrekte

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka përgëzuar klubet për përfundimin e suksesshëm të stinorit vjeshtor të garave. Presidenti Ademi ka vlerësuar kontributin e secilit të përfshirë në futboll për garë korrekte dhe cilësore, teksa ka veçuar sistemin VAR, si një prej risive që e ka lehtësuar punën në futbollin e Kosovës. Ai, po ashtu, ka uruar të gjithë futbollistët dhe komunitetin e futbollit në tërësi për festat e fundvitit. “E përmbyllëm kaptinën e parë në të gjitha garat e futbollit tonë. Perdja e stinorit vjeshtor u mbyll me një ndeshje përplot emocione në Suharekë, ku u vendos skuadra lidere e BKT Superligës për pjesën e parë të garave. E ndeshjet e këtuja në këtë stinor nuk ishin të pakta, ani pse për shkak të pandemisë numri i tifozëve ishte i limituar, e në disa stadione ende është duke u punuar për krijimin e kushteve më të volitshme si për lojtarët ashtu edhe për tifozët. Edhe ky stinor ishte i vështirë duke pasur parasysh përballjen e vazhdueshme me pandeminë Covid-19, por një lehtësim i madh për të gjithë të përfshirët



në futbollin tonë ishte aplikimi i sistemit VAR në ndeshjet e BKT Superligës. VAR-i e bëri garën shumë më korrekte dhe i eliminoi gabimet në ndarjen e drejtësisë. Ishte ky një projekt i kushtueshëm, por tejet i domosdoshëm për futbollin tonë”, ka thënë Ademi. “I përgëzoj të gjitha klubet për futbollin e shfaqur dhe garën korrekte, si dhe zyrtarët e ndeshjeve për kryerjen e detyrave në mënyrë të dinjitetshme. Shpresoj e besoj se stinori pranveror do të na sjellë garë edhe më interesante dhe emocione të pafundme me prani

më të madhe të tifozëve në stadione. Tani të gjithë futbollistëve dhe të përfshirëve të tjerë në futboll u dëshiroj pushim të këndshëm dhe ditë të lumtura për festat e fundvitit, derisa uroj që pushimin ndërmjet dy stinorëve klubet ta shfrytëzojnë për rritje të mëtejme të nivelit organizativ, në mënyrë që në pranverë të kemi garë edhe më joshëse. Në anën tjetër, FFK do të vazhdojë realizimin e projekteve të ndryshme me qëllim të përparimit të mëtutjeshëm të lojës së futbollit në të gjitha segmentet”, ka deklaruar Ademi.

Sarah Mgbeike, MVP e xhiros së dhjetë

Prishtinë, 13 dhjetor - Xhiroja e dhjetë ishte nën hijen e derbit Prishtina - Penza, ku skuadra prishtinase me fitoren 91:65 siguroi vendin e parë si kampione vjeshtore me dhjetë fitore në dhjetë ndeshje. Vashat prishtinase ishin më të mira në derbi dhe stinorin vjeshtor. Në derbi më e mira ishte Sarah Mgbeike me 25 pikë, 16 kërcime, tri asistime, tri vjedhje të

topit dhe pesë bllokada. Mgbeike ishte ndër lojtarët më të dalluara të kryeqytetasve në këtë edicion dhe nuk është hera e parë që shpallet MVP. Ajo u ndihmua nga Aisia Robertson me 21 pikë, tri kërcime, 11 asistime dhe gjashtë vjedhje të topit, si dhe kapitenia Arbnore Përçuku me 15 pikë, nëntë kërcime dhe tetë asistime dhe katër vjedhje të

topit. Bashkimi mundi Trepçën në udhëtim 66:79, ku u dallua Janelle Porter e Bashkimit me 21 pikë, 12 kërcime, katër asistime dhe tri vjedhje të topit. Kapitenia e Vëllaznimit, Rina Hoda, hyn në top 5, pasi ndihmoi skuadrën e saj të shënojë fitore ndaj Kastriotit në udhëtim 36:91, me 28 pikë, pesë kërcime, gjashtë asistime dhe tetë vjedhje të topit.

TOP 5-SHJA:

Sarah Mgbeike	(Prishtina) 25 pikë, 16 kërcime, 3 asistime
Aisia Robertson	(Prishtina) 21 pikë, 3 kërcime, 11 asistime
Arbnore Përçuku	(Prishtina) 15 pikë, nëntë kërcime dhe tetë asistime
Janelle Porter	(Bashkimi) 21 pikë, 12 kërcime, 4 asistime
Rina Hoda	(Vëllaznimi) 28 pikë, 5 kërcime, 6 asistime.



Shefi i Ferrarit: Arritëm objektivin, ky ishte maksimumi ynë

Ferrari e mbylli këtë sezon të Formulës 1 me një podium, me pilotin spanjoll Carlos Sainz që u rendit i treti në garën e zhvilluar në Abu Dhabi. Një rezultat që pasqyron edhe sezonin e

“kokëkuqes”, që u klasifikua e treta në renditjen për konstruktorë, pas Mercedesit dhe Red Bullit. Ky ishte edhe objektivi i makinës italiane, pas dështimit të vitit të kaluar, ku

u klasifikua në vendin e gjashtë. “Podiumi është i bukur, por kur sheh të tjerët që festojnë nuk je i kënaqur. Gjithsesi, vendi i tretë për konstruktorë ishte maksimumi që mund të

arrinim këtë sezon”, ka thënë Mattia Binotto, shef i Ferrarit. “Punuam shumë gjatë gjithë këtij sezoni, por tani do të nisë një epokë e re dhe është e rëndësishme të shohim se ku do të jemi

krahasuar me rivalët. U rritëm shumë krahasuar me vjet dhe pilotët tanë arritën objektivat. Janë të dy të fortë dhe kemi besim tek aftësitë e tyre për të ardhmen”, ka shtuar Binotto.

SHKURT

Nadali: Ronaldo është futbollisti më i mirë

Tenisti spanjoll Rafael Nadal është një i pasionuar pas sportit dhe tifoz i skuadrës së Real Madridit. Në një intervistë për mediet e vendit të tij ai ka zbuluar se cili është futbollisti i tij i pëlqyer. Në majë të listës nuk është as Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo, por ish-futbollisti brazilian Ronaldo (fenomeni). “Jam rritur duke parë Ronaldon duke luajtur. Gjithnjë e kam admiruar lojën dhe sjelljen e tij dhe kam shkuar disa herë për ta parë duke luajtur në stadium. Për mua mbetet lojtari i preferuar”, ka thënë Nadali.

Ibra: Nuk më nevojitet ‘Topi i Artë’ për të dëshmuar se jam më i miri në botë

Zlatan Ibrahimoviç ka thënë se nuk i nevojitet “Topi i Artë” për të dëshmuar se është lojtari më i mirë në botë, si dhe zbulon fshhtësinë e jetëgjatësisë në futboll.


Sulmuesi suedez e paraqiti librin e vet “Adrenalina” gjatë një mbrëmjeje gala në Milano të dielën. Lionel Messi e fitoi “Topin e Artë” për herë të shtatë rekorde muajin e kaluar, ndërkohë që Ibrahimoviç nuk ka qenë afër ta fitojë asnjëherë në karrierën e tij të gjatë. Menaxheri i tij Mino Raiola ka thënë së fundmi se nuk e merr seriozisht këtë çmim për shkak se suedezi s’e ka fituar kurrë. Por Ibrahimoviç nuk pajtohet me të, pasi thotë: “‘Topi i Artë’ është i mirë. Por mua nuk më nevojitet ai për të dëshmuar se jam më i miri”. Të shtunën Ibra e shënoi golin e 300 në pesë ligat kryesore evropiane. Ai u bashkohet Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos si lojtarët e vetëm me këtë arritje. I pyetur për fshhtësinë e jetëgjatësisë së tij në futboll, 40-vjeçari ka deklaruar: “Është mendësia. Unë stërvitem njësoj siç luaj. Çdo ditë është finale”.

Xavi nxjerr në shitje pesë futbollistë

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, është duke u përgatitur që t’i largojë nga “Camp Nou” disa futbollistë. Sipas “Mundo Deportivo”, Philippe Coutinho dhe Samuel Umtiti janë dy futbollistët e parë që janë nxjerrë në shitje nga Xavi, kurse pas tyre pritet të shiten edhe Frenkie de Jong, Sergino Dest dhe Oscar Mingueza.

Mbappe hyn në historinë e Ligës 1

Sulmuesi i Paris Saint-Germainit, Kylian Mbappe, u bë lojtari më i ri në historinë e Ligës 1 që ka shënuar 100 gola për një ekip të vetëm në ndeshjen e tij për Paris Saint-Germain kundër Monakos të dielën. Sulmuesi hapi rezultatin nga penalltia pas 12 minutash kundër ish-klubit të tij në “Parc des Princes” pas gabimit të Djibril Sidibe ndaj Angel Di Maria. Pasimi i padrejtë i Youssouf Fofanas i dha më pas mundësinë Lionel Messit për të sulmuar në pjesën e parë të pjesës së parë, argjentinas i ngarkoi Mbappe, i cili u përkul në këndin e poshtëm djathtas për ta arritur rekordin e 100 golave. Vetëm 22 vjeç e 357 ditë, Mbappe është lojtari më i ri që ka arritur suksesin për një klub në historinë e ligës franceze që kur Opta filloi regjistrimin e të dhënave në vitet 1950-1951. Mbappe ka nëntë gola dhe 14 asistime në emrin e tij në Ligën 1 këtë sezon për skuadrën e Mauricio Pochettino, i cili mban një epërsi të konsiderueshme në krye të tabelës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E SUHAREKËS
 OPSTINE SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DREJTORIA E ARSIMIT
 05nr.1763 datë 13.12.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm),UA MASHTnr.08/2021,UA.MASHT-nr.34/2014-Funksionalizimi i shërbimit profesional pedagogjik-psikologjik mësimdhënës në shkollë ,Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. SHFMU" Shkëndija"-Suharekë

- Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës angleze për 10 orë mësim (për kohë të caktuar deri më datë 31.08.2022).
 Paga mujore:koeficienti A-421/1
 Kualifikimi:Sipas normativit UA MASHT nr.05/2021

2. IP"Fluturat"-Suharekë

- **Katër edukator/e** (dy edukatore në paralelen në Studençan dhe dy edukatore në paralelen në Samdraxhë)
 Paga Mujore :koeficienti A-393/1
 Kohëzgjatja e kontratës:deri më 31.08.2022 me mundësi vazhdimi
 Kualifikimi:Sipas normativit UA MASHT nr.05/2021
- **Tre kuzhinier/e** (një në paralelen në Studençan,një në Samdraxhë dhe një në Duhël)
 Paga mujore:koeficienti A 4.8
 Kohëzgjatja e kontratës :për kohë të pacaktuar,me orarë të plotë
 Periudha provuese:6 muaj
 Kualifikimi:shkolla e mesme profesionale

1. SHFMU"Vaso Pashë Shkodrani"-Leshan

- Një punëtor/e teknik/ndihmës
 Paga mujore :koeficienti A 4/1
 Kohëzgjatja e kontratës:për periudhë të pacaktuar,me orar të plotë
 Periudha provuese:6 muaj
 Kualifikimi:Shkolla e mesme

3. SHFMU"Sadri Duhla"në Duhël

- Vendi i punës:Psikolog/e shkolle
 Paga mujore:Koefficienti 6.6
 Kohëzgjatja e kontratës:për periudhë të pacaktuar,me orar të plotë
 Periudha provuese:6 muaj
 Kualifikimi : Fakulteti Filozofik-drejtimi psikologjisë sipas UA. MASHT nr. 34/2014

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit,Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)


Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
 Remzi Bajselmani





REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E SUHAREKËS
 OPSTINE SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
 05 br. 1763 od 13.12. 2021 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068,AI br.05/2021(Normariva u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja),UA.MONT-a br.08/2021, AU- MONT-a br.34/2014(Funksionisanje pedagoško-psikološke službe u školama), Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru,Opština direkcija za obrazovanje objavljuj i novo obavljuje:

KONKURS

Za popunu slobodnih mesta za školsku godinu 2021/2022

1. OSNŠ" Škëndija"-Suva Reka

- Jedan nastavnik/ca za predmet englezkog jezika za 10 časova (na određeno vreme do 31.08.2022)
 Mesečna plata: koeficijent A-421/1
 Stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021

2. Dečji vrtić"Fluturat" –Suva Reka

- **Četiri vaspitačica** za odelenju u Studenčane i Samdraže
 Mesečna plata: koeficijent A- 393/1
 Trajanje ugovora:do 31.08.2022,sa mogućnošću produženja
 Stručna sprema prema normative AU MONT br.05/2021
- **Tri kuvara/ice** za Studenčane,Samdrađe i Dulje
 Mesečna plata: koeficijent A 4.8
 Trajanje ugovora: na neodređeno vreme, puno radno vreme
 Probni period: šest meseci
 Stručna sprema: Profesionalna srednja škola

3. ONSS " Vaso Pashë Shkodrani"-Lešane

- Jedan tehnički / pomoćni radnik
 Mesečna plata:koeficienta A 4/1
 Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme, puno radno vreme
 Trajanje probnog rada:Šest(6)meseci
 Stručna sprema:Srednja škola

4. ONSS"Sadri Duhla"-Dule

- Radno mesto : Školski psiholog
 Mesečna plata: koeficijent: 6.6
 Trajanje ugovora: na neodređeno vreme, puno radno vreme
 Probni period: šest meseci
 Kualifikacija: Filozofski fakultet-smer psihologija na osnovu AU- MONT-a br.34/2014

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
 - Ekstrakt rođenja
 - Lična karta (fotokopija)
 - Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
 - Dokaz da nije pod istragom
 - Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)
 - Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a
- Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano,dok će se originalni dokumenti podstavljavati u intervju.
 Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.
 Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15(petnaest)dana od obavljenu u novinama

Oraspedu intervju bičete obavešteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor profete
 Remzi Bajselmani






REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1764 datë 13.12.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.05/2021 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.08/2021, Udhëzimit Administrativ nr.19/2018, Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, marrëveshjes në mes të OJQ Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VORAE) dhe Komunës së Suharekës nr.01-016-65977 të datës 18.09.2019, Drejtoria Komonale e Arsimit shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

1.SHFMU" Shkëndija"-Suharekë
➤ Një mësimdhënës për Qendrën mësimore

Kohëzgjatja e kontratës :për kohë të caktuar deri më datë 31.08.2022

Paga mujore : 350,00 Euro

Kushtet: Të ketë kualifikim për mësimdhënie sipas normativit UA.05/2021:

Të ketë njohuri, praktikë dhe përvojë në punën me fëmijë,
Të njohë gjuhën, kulturën dhe traditat e komuniteteve në lokalitetin ku vepron qendra.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmi që nuk jeni nën hetime.
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje).
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës ,duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Minsitria e Arsimit, Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim, (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHTI(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati për pranimin e aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCES DHE TEKNOLOGGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I
OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT
EDUCATION

Nr:1211/1
Dt:13.12.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së Sh. M. L. T "11 Marsi", në Prizren, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

RI-SHPALLJE E KONKURSIONIT
Për plotësimin e vendit të lirë në Shkollën e Mesme të Teknike "11 Marsi", në Prizren për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh M LT	Sh. M. L. T "11 Marsi", në Prizren	Prishtinë	Një(1) instruktor të lendes së arkitekturës/ ndërtimtarisë 10 orë mësimore:	Vend i lirë

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurimit:

Afati i konkurimit është 7 që nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Shkollën e Mesme Teknike "11 Marsi" në Prizren.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br.1764 od 13.12.2021 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03/L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u republiku Kosova br.04/L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03/L-068, AI br.05/2021(Normativa u stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU-MONT br.08/2021, AU-MONT br.19/2018, Administrativnog uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog mesta u javnom sektoru, sporazum između glas VoRAE i Opštine Suva Reke br.01-016-65977 datum 18.09.2019, Opština direkcija za obrazovanje objavljuje:

KONKURS
Za popunu slobodnih mesta

1.OSNŠ" Škendija"-Suva Reka
➤ Jedan nastavnik u Centar za učenje

Trajanje ugovora: za odeljenje vreme do 31.08.2022
Mesečna plata: 350,00 €

Uslovi: Da ima kvalifikaciju za nastave -prema normativa AU-MONT br.05/2021;
Da ima praktično znanje i iskustov za rad sa decom;
Da poznaje jezik, kulturu i tradiciju lokalne zajednice u kojoj deluje centar za učenje.

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) kokandidat popunjava
- Ekstrakt rodenja
- Lična karta (fotokopija)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)
- Dokaz da nije pod istragom
- Dokaz o Radnom iskustvu u obrazovanju(ako ga ima)
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju imati nostrifikovane diplome MONT-a

Kopletirane dokumenti se dostavljaju u fotokopirano, dok će se originalni dokumenti predstavljavati u intervju.

Komisija neće razmatrati nepotpune i dokumenta prispela nakon isteka roka.

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelarija u Opštine Suva Reka.

Konkurs ostaje otvoren 15(petnaest)dana od obavljenu u novinama

O rasporedu intervju biće obavesteni na web stranici Opštine Suva Reka i oglasnoj table ODO.

Direktor profsfe
Remzi Bajselmani

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 267/21
Data: 09.12.2021

Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Përparimi" Sh.A-Vushtrri

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), bazuar në nenin 4, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 7/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik. Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

Titulli: Sigurim fizik-roje

Numri i ekzekutuesve: 2 (dy)
Orët e punës: 40 në javë
Kohëzgjatja: Me kohë të caktuar 1 vitë (një vitë) me mundësi vazhdimi, punë provuese 6 muaj

Kushtet , aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:

- CV-në
- Të ketë Diplomë të shkollës së Mesme,
- Aftësi organizative, planifikuese dhe kordinuese
- Të prezantoj letërnjoftimin;
- Çertifikatë nga Gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3 muaj);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

- Shkathësi fizike
- Aftësi të mira komunikuese

Koeficienti i pagës: sipas akteve të brendshëm të Ndërmarrjes

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik.
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent-mbikëqyrës in e sigurimit.
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik.
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë.
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit.
- Për punën që kryen i përgjigjet mbikëqyrësit të sigurimit.

Aplikacionin së bashku me diplomën, CV etj. Mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në NPL "Përparimi" Sh.A në Vushtrri, rruga Gjergj Kastrioti Skenderbeu nr.82, nga ora 8:00-16:00h

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 10.12.2021 deri më datën 24.12.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues.

Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri ofron mundësin të barabarët punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të të gjitha komuniteteve.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 266/21
Data: 09.12.2021

Lokalno Javno Preduzeće NPL "Përparimi" A.D - Vučitrn

Na osnovu člana 7 i 8 Zakona o radu (Zakon br. 03L / 212), I bazirajući na Administrativnog uputstva br. 07/2017, zkon 4 i 5 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru. Lokalno Javno Preduzeće "Përparimi" A.D u Vučitrnu objavljuje:

Konkurs i unutarzni
Za popunjavanje upražnjenog mjesta:

Naziv: Šef jedinice fizičkog obezbeđenja u NPL "Perparimi" A.D
Stručna sprema: Srednja škole ili Fakultetska diploma
Radni staž: 1 godina najmanje sličan rad u bilo kojoj drugoj instituciji
Br. izvršilaca: (1) Jedan
Koeficijenti:
Posebni uslovi:

- Sposobnost rada u timu, pod pritiskom i da svedoči fleksibilitnosti na poslu;
- Dobre veštine timskog rada kao i dobre komunikacijske veštine.

Dužnosti i odgovornosti:

- Vodi evidenciju službe fizičkog obezbeđenja.
- Koordinira rad između glavnog izvršnog direktora i osoblja fizičkog obezbeđenja.
- Obezbeđuje redovno funkcionisanje i efektivno pružanje usluga fizičkog obezbeđenja u svim zgradama.
- Osigurava da radnici fizičkog obezbeđenja obavljaju svoje dužnosti u skladu sa potrebnim pravilima i standardima.
- Sastavlja registar radnog vremena radnika fizičkog obezbeđenja, ažurira i reprogramira raspored radi pokrivanja odsustva kada je to potrebno.
- Osigurava i kontroliše efektivnu i ekonomičnu upotrebu radne imovine.
- Izrađuje izveštaje o obavljenim poslovima u okviru jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Odgovoran glavnom izvršnom službeniku za svoj rad

Aplikacija zajedno sa diplomom, CV, itd. Mogu se dostaviti u Arhivu, u NPL "Përparimi" A.D u Vučitrnu, ulica Gjergj Kastrioti Skenderbeu br.82, od 8:00-16:00h

Konkurs će biti otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama od 24.11.2021. do 08.12.2021. Zajtjevi dostavljeni nakon roka i nepotpuni sa relevantnom dokumentacijom neće se razmatrati od strane Komisije za ocjenjivanje.

Lokalno Javno Preduzeće „Përparimi“ A.D u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo svih zajednica.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Demir Zeqiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike të shkollës "Mithat Frashëri" Istog.
- Burim Qaushi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U. "Dy Dëshmorët " në fshatin Sheremet KK Gjakovë.
- Nasuf Kurtaj shpall te pavlefshme dy dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren .
- Safet Guraziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- EDG O.P me numër te regjistrimit te biznesit: 70557819 me adrese Prishtinë, Holger Pedersen Nr.11 shpalli te pavlefshme certifikatën e regjistrimit e leshura nga ARBK.
- Blerim Nue Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. IV të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Mirlind Rama shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues